

61/3  
25.03.1968

## RREGULLORE E KËSHILLIT TË BOTIMEVE TË ASH

### *Neni 1*

Këshilli i Botimeve i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (më tej KB) është organ që përpunon politikën e botimeve të ASH, në përputhje me programet shkencore të Asamblesë së Akademisë, dhe funksionon pranë Kryesisë së saj.

### *Neni 2*

KB përbëhet nga studiues të cilësuar të fushave kryesore të veprimtarisë botuese të ASH, të propozuar nga Kryesia dhe të miratuar nga Këshilli Ekzekutiv për një mandat katërvjeçar.

### *Neni 3*

Kryetari i Akademisë është ex officio i KB.

### *Neni 4*

KB zgjedh një sekretar shkencor që ndihmon kryetarin në punën e tij dhe ndjek çështjet operative, përgatit materialet e mbledhjeve etj.

### *Neni 5*

KB ka kompetencë:

- a) të caktojë kriteret themelore për botimet e Akademisë mbi bazën e politikës shkencore të miratuar nga Asambleja e ASH.
- b) Të përcaktojë përparësitë e botimeve nga fushat e ndryshme të shkencës dhe kuotat e botimeve në përputhje me këto përparësi, në varësi të buxhetit të akorduar për botimet.
- c) Të miratojë llojet e organeve periodike që boton Akademia.
- d) Të vendosë për botimin e periodikëve të rinj ose mbylljen e periodikëve ekzistues, kur e gjykon të domosdoshme, në përputhje me politikën e botimeve të ASH.
- e) Të miratojë për shtyp (në bazë të paktën të dy recensioneve) vepra të rëndësishme kombëtare, duke

caktuar recensentët dhe tirazhin e veprave. Në raste të veçanta mund të ketë botime edhe në gjuhë të huaja.

#### **Neni 6**

KB i merr vendimet e tij me votim të hapur dhe në raste të veçanta me votim të fshehtë (kur kjo është vendosur nga shumica e anëtarëve).

#### **Neni 7**

Vendimet e KB janë të vlefshme kur në mbledhje janë të pranishëm jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij dhe ato marrin shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm.

#### **Neni 8**

KB mblidhet sipas rastit disa herë në vit, por jo më pak se dy herë.

#### **Neni 9**

Mbledhjen e KB e thërret kryetari. Mbledhja e KB mund të thirret edhe me kërkesën e 1/3 të anëtarëve të tij.

#### **Neni 10**

Anëtarët e KB shpërblehen për çdo mbledhje në masën 3000 (tremijë) lekë, kurse kryetari dhe sekretari në masën 4000 (katërmijë) lekë.

**K R Y E T A R I**

**AKADEMIK GUDAR BEQIRAJ**

